

**EVERY
CASUALTY
COUNTS**



Standardet për regjistrimin e
viktimave: Përmbledhje

Përmbajtja

Standardet për regjistrimin e viktimave: Përmbledhje	2
Parimet e regjistrimit të viktimave	3
1. Mos bëj dëm	3
2. Transparenca	3
3. Përfshirja	3
4. Qëndrueshmëria	3
5. Përgjegjësia	3
Qëllimet themelore të mbledhjes së të dhënave për regjistruarit e viktimave	4
Standardet për regjistrimin e viktimave	5
1. Transparenca organizative	5
2. Metodologjia	5
3. Përkufizimet dhe kategorizimet	6
4. Siguria	6
5. Publikimi i të dhënave të regjistrimit të viktimave	7

Standardet për regjistrimin e viktimave: Përmbledhje

Ky dokument është një përmbledhje e shkurtër, e thjeshtë dhe e arritshme e *Standardeve për regjistrimin e viktimave*. Dokumenti i plotë është në dispozicion në www.everycasualty.org.

Standardet për regjistrimin e viktimave u zhvilluan nga Rrjeti i Regjistruessve të Viktimave i "Every Casualty Counts" për të nxitur praktikën më të mirë, për të inkurajuar harmonizimin dhe për të mundësuar përdorimin më të gjerë të punës së regjistruessve të viktimave. Ato nuk kanë për qëllim të përdoren si udhëzime operative. Përkundrazi, Standardet synojnë të inkurajojnë regjistruessit e viktimave që të marrin parasysh aspektet e rëndësishme të praktikës së mirë dhe se si mund të zbatohen ato në projektet e tyre të regjistrimit të viktimave.

Përveçse i ndihmojnë ushtruesit e regjistrimit të viktimave, këto Standarde synojnë që t'i bëjnë të dhënat e viktimave më të lehta për t'u përdorur dhe për t'u ndarë. Ato u ofrojnë përdoruesve fundorë të të dhënave të viktimave kritere objektive dhe të matshme, që i ndihmojnë që të vendosin nëse dhe se si të përdorin të dhënat e viktimave të paraqitura nga burime të ndryshme.

Për të zgjeruar shtrirjen dhe përdorimin e Standardeve, kjo përmbledhje është përkthyer në disa nga gjuhët më të rëndësishme për regjistruessit ekzistues dhe të mundshëm të viktimave. Për informacione dhe burime të mëtejshme, kontaktoni me "Every Casualty Counts".

Parimet e regjistrimit të viktimave

Pesë parime bazë u vendosën gjatë zhvillimit të Standardeve. Të gjitha standardet e paraqitura këtu janë të mbështetura në këto parime dhe duhet të ndiqen gjatë punës së çdo projekti.

1. Mos bëj dëm

Shmangia e dëmit të mëtejshëm ndaj të gjallëve është një parim aq themelor i regjistrimit të viktimave, që buron nga etika mjekësore, sa që mund t'i zhbëjë katër parimet e tjera. Ai vlen për të gjitha aspektet e regjistrimit të viktimave, nga mbledhja e të dhënave deri te politikat e sigurisë dhe publikimi i të dhënave.

2. Transparenca

Regjistruesit e viktimave duhet të jenë sa më transparentë që të jetë e mundur për të gjitha aspektet e aktiviteteve të tyre, përfshirë strukturën organizative, metodologjinë dhe politikat e sigurisë për personelin, dëshmitarët dhe të dhënat. Transparenca nxit besimin në të dhënat, ndihmon në interpretimin e saktë të tyre dhe inkurajon vëzhgimin e dobishëm.

3. Përfshirja

Regjistruesit e të dhënave nuk kanë pse të jenë politikisht asnjans, por duhet të përpiqen që të përfshijnë të gjitha ngjarjet dhe vdekjet që ndodhin në kuadër të projektit, duke përdorur përkufizimet që vlejné për të gjitha palët në mënyrë të barabartë. Regjistruesit e viktimave duhet të theksojnë qartë se cilat të dhëna, nëse ka ndonjë, i përjashtojné nga regjistrimi i tyre dhe pse. Këtu mund të përfshihen, për shembull, vështirësitë në mbledhjen e informacionit nga komunitetet në kundërshtim me përkatësinë politike dhe të komunitetit të regjistruesit të viktimave.

4. Qëndrueshmëria

Qëndrueshmëria, veçanërisht për sa u përket metodave për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, është vendimtare për të siguruar që regjistrat e viktimave të mund të përdoren për krahasime domethënëse nëpër vende dhe kohë. Kur ndryshojné metodat si pasojë e rrethanave të jashtme, ato duhet të shqyrtohen me kujdes dhe të tregohen qartë, për të siguruar cilësi të qëndrueshme të të dhënave.

5. Përgjegjësia

Regjistruesit e viktimave duhet të veprojnë me përgjegjësi ndaj të gjithë atyre që ndikohen ose përfshihen në punën e tyre, duke përfshirë burimet dhe personelin e tyre. Ushtrimi i përgjegjësisë duhet të jetë i vëzhgueshëm në mënyrë transparente, ashtu që të ndërtohet besimi i atyre që japin dhe përdorin informacionin e tyre.

Qëllimet themelore të mbledhjes së të dhënave për regjistruesit e viktimave

Regjistruesit e viktimave caktojnë kërkesat e mbledhjes së informacionit në përputhje me qëllimet specifike të projektit. Megjithatë, ka një paketë minimale informacioni themelor të cilin të gjithë regjistruesit e viktimave duhet të përpiqen që ta përfshijnë. Këto janë:

Qëllimet themelore të mbledhjes së të dhënave	
Vendndodhja	Regjistro nivelin më të lartë të detajeve në dispozicion, për shembull emrin e qytetit ose fshatit ose madje edhe koordinatat e plota të GPS, nëse është e mundur.
Data / Ora	Regjistro nivelin më të lartë të detajeve në dispozicion, përfshirë datën dhe orën, nëse dihen.
Burimet	Regjistro kategoritë e burimeve, si raportet e lajmeve, dokumentet zyrtare, angazhimi i bashkëpunëtorëve të jashtëm, dëshmia e dëshmitarëve. Zakonisht, burimet duhet të ruhen, me lidhje për te regjistrat e viktimave. Burimet e ndjeshme, si dëshmia e dëshmitarit, duhet të mbrohen.
Numri i viktimave	Kur informacioni identifikues në lidhje me individët e vrarë në një incident nuk është në dispozicion, regjistro numrin e viktimave si masë e përkohshme, derisa të mund të merren më tepër detaje.
Emri	Regjistro emrin e çdo viktime, duke përdorur njohuri të dorës së parë të konventave lokale të emërimit. Sigurohu që të jetë e mundur përfshirja e emrave të ndryshëm për individin e njëjtë, kur është e nevojshme (për shembull, pseudonimet ose emrat e luftës).
Mosha	Regjistro datëlindjen e çdo viktime ose moshën në kohën e vdekjes ose zhdukjes së tyre. Nëse ky informacion nuk është në dispozicion, regjistro nëse viktimja ishte fëmijë ose i rritur përmes kriterëve transparente dhe të qëndrueshme. Kategoritë e mëtejshme si foshnjë, i porsalindur, adoleshent ose i moshuar, duhet të zbatohen gjithmonë, në rast se përdoren.
Seksi/gjinia	Regjistro seksin/gjininë e çdo personi kur të jetë e mundur.
Detajet e vdekjes	Ky informacion mund të organizohet në mënyra të ndryshme, për shembull sipas armës, shkakut mjekësor të vdekjes ose përkrahimit të incidentit.
Palët e përfshira	Regjistro grupet ose individët të cilët janë raportuar të kenë qenë të përfshirë në incident, përfshirë palët e konfliktit të pranishme dhe grupet ose individët që kanë marrë përgjegjësi.

Standardet për regjistrimin e viktimave

1. Transparenca organizative

Regjistruesit e viktimave duhet gjithmonë:

- të jenë transparentë për misionin dhe motivet e tyre për regjistrimin.
- të bëjnë transparent dhe të arritshëm për publikun informacionin dhe metodologjinë e tyre.

Regjistruesit e viktimave duhet të përpiqen të:

- sigurojnë informacion rreth përkatësive të tyre politike apo të një lloji tjetër të cilat mund të kompromentojnë përkushtimin e tyre ndaj regjistrimit përfshirës.
- bëjnë transparente dhe të arritshme nga të gjitha palët pjesëmarrëse strukturën organizative të organizatës së tyre.
- bëjnë transparent dhe të arritshëm nga publiku informacionin për financuesit.

2. Metodologjia

Regjistruesit e viktimave duhet gjithmonë:

- të kenë mjete të pastra për t'u marrë me provat e dokumentuara dhe dëshmitë e dëshmitarëve.
- të kenë një sistem të rregullt dhe të mirëorganizuar për përpunimin e informacionit, ndërkohë që lënë hapësirë për gjykimin dhe fleksibilitetin njerëzor.
- regjistroni sistematikisht informacionin e specifikuar.
- të ketë një proces për të mbështetur dhe vlerësuar të dhënat e mbledhura.
- të kenë një sistem për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes burimeve.
- të kenë mënyra për të shmangur dhe zgjidhur regjistrimin e dyfishtë.

Regjistruesit e viktimave duhet të përpiqen të:

- përdorin burime të shumëfishta të pavarura për çdo regjistrim sa më shumë të jetë e mundur.
- jenë të vetëdijshëm për të gjitha burimet e mundshme që janë të disponueshme për ta, si dhe pikat e tyre të forta dhe kufizimet.
- konsiderojnë përdorimin e një sistemi vlerësimi për të matur besueshmërinë e çdo burimi dhe të jetë i hapur për rishikim.
- mos refuzojnë asnjë burim që mund t'ju ofrojë informacion të dobishëm, edhe nëse informacioni i dhënë është minimal.
- ruajnë çdo dokument të dobishëm.
- synojnë të konfirmojnë të dhënat e tyre me burime të shumëfishta të pavarura.
- krijojnë procedura për të siguruar futje të vazhdueshme të dhënave.

- mbajnë futjet e të dhënave të hapura për korrigjim të gjitha dhe përfshirje të informacionit të ri.
- ndajnë procesin e regjistrimit të viktimave te njerëz të ndryshëm për të thjeshtuar punën dhe për të minimizuar gabimet njerëzore.
- konsiderojnë rishikimin e të dhënave të njëri-tjetrit nga anëtarët e stafit përpara se të konfirmojnë një incident/individ.

3. Përkufizimet dhe kategorizimet

Regjistruesit e viktimave duhet gjithmonë:

- të vendosin kritere të qarta përfshirjeje dhe përjashtimi, që janë sqaruar në mënyrë të hapur.
- të zgjedhin përkufizimet dhe kategoritë sipas kontekstit dhe qëllimit.
- të përcaktojnë një grup fillestar me pika informuese, kategori dhe përkufizime përpara fillimit të nismës së regjistrimit të viktimave dhe t'i zbatojnë këto vazhdimisht në procesin e tyre të regjistrimit.

Regjistruesit e viktimave duhet të përpiqen të:

- kenë një opsion për të karakterizuar informacionin si "të pasigurt" apo "provizor" kur është e nevojshme.
- konsiderojnë problemet e kategorizimit kur krijojnë bazën e tyre të të dhënave.
- regjistrojnë vdekjet e individëve të pidentifikuar me detaje nëse është e mundur.
- këshillohen me dhe/ose përpilojnë baza të dhënash të njerëzve të humbur, për të ndihmuar në qartësimin e fatit të viktimave të pidentifikuara.

4. Siguria

Regjistruesit e viktimave duhet gjithmonë:

- të jenë të vetëdijshëm që rreziqet ndryshojnë dhe të identifikojnë rreziqet specifike që lidhen me çdo fazë të ciklit të regjistrimit të viktimave.
- të marrin pëlqimin e informuar nga dëshmitari të përshtatshëm për të gjitha qëllimet që do të përdoret informacioni i tyre.
- të përcaktojnë qartë marrëdhëniet me të gjithë anëtarët e grupit nëpërmjet kontratave të me shkrim apo verbale, duke kërkuar konfidencialitet dhe ekskluzivitet kur është e përshtatshme.
- të sigurohen që i gjithë stafi është i vetëdijshëm, kupton dhe pranon të ketë qasje te masat e sigurisë që përdoren për t'i mbrojtur ata.
- të zhvillojnë dhe sigurojnë stafit protokolle sigurie, përfshirë trajnimin sipas nevojës.
- të garantojnë një nivel qasje ndaj mbështetjes psikologjike për stafin e tyre.
- të kenë një plan për ruajtjen e të dhënave përpara se të fillojnë mbledhjen e të dhënave, duke përfshirë furnizimet rezervë.

- të marrin parasysh faktorët ligjorë, teknologjikë dhe njerëzorë kur trajtojnë çështje sigurie të dhënash, duke përfshirë ligjet për mbrojtjen e të dhënave.
- të përcaktojnë qartë kërkesat e sigurisë së të dhënave kur ndajnë të dhëna me palët e tjera pjesëmarrëse.
- të planifikojnë mundësinë e vjedhjes së të dhënave.
- të vlerësojnë me kujdes nëse mjetet e përdorura i përmbushin qëllimet e tyre të sigurisë së të dhënave.
- Regjistruesit e viktimave duhet të përpiqen të:
 - ndërmarrin vlerësim të vazhdueshme rreziku për të mundësuar sigurinë e njerëzve që përfshijnë në aktivitetet e regjistrimit të viktimave
 - analizojnë rrezikun që lidhet me llojin e të dhënave që ata mbledhin.
 - mbledhin vetëm informacionin që ju duhet dhe ta mbrojnë atë siç duhet.
 - jenë të vetëdijshëm për ofruesit e lehtësimit njerëzor dhe ndihmën e të drejtave të njeriut në zonën ku veprojnë, në mënyrë që t'i drejtojnë dëshmitarët e drejtpërdrejt te ata nëse kanë nevojë për ndihmë.
 - ofrojnë nivele të ndryshme qasje ndaj të dhënave sensitive brenda organizatës, bazuar në faktet që duhet të dinë.
 - planifikojnë mënyrën e arkivimit të të dhënave kur të mbarojë projekti.

5. Publikimi i të dhënave të regjistrimit të viktimave

Regjistruesit e viktimave duhet gjithmonë:

- të sinjalizojnë nëse/kur informacioni i publikuar nuk është mjaftueshëm i konfirmuar për t'u konsideruar plotësisht i miratuar.

Regjistruesit e viktimave duhet të përpiqen të:

- konsiderojnë të gjitha mënyrat se si të dhënat e tyre mund të jenë të dobishëm dhe për kë, kur marrin vendime për ato që do të publikohen.
- identifikojnë arsyet e tyre për vendimin e mospublikimit të të dhënave specifike.
- ndajnë të dhënat e publikuara sipas objektivave të projektit, por gjithmonë të kenë parasysh objektivin përfundimtar të njohjes së çdo viktime.
- vlerësojnë dhe identifikojnë mënyrat më efektive për të komunikuar të dhënat e tyre.
- gjithmonë përpiquni të publikoni të dhënat e tyre në gjuhën (et) lokale të rajonit në të cilin bazohen aktivitetet e tyre.
- konsiderojnë ndërmarrjen e aktiviteteve të shpërndarjes për të përfshirë audiencën të rëndësishme të synuara me të dhënat e tyre.
- përpiqen të ndajnë të dhënat e tyre sa më shumë të jetë e mundur për të shmangur punën e dyfishtë, por të vendosin nivelin e detajeve që do të ofrojnë rast pas rasti.